



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
QENDRA E KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE TË MBROJTJES

RAPORT MONITORIMI/ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

**QENDRA E KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE TË MBROJTJES, DHE MUZEUT TË FORCAVE
TË ARMATOSURA**

2025

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	2
Qasja vlerësuese.....	3
Metodologjia e vlerësimit.....	3
GJETJET E RAPORTIT	3
Objektivi 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	3
Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	4
Objektivi 3: Transparencë pro aktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.....	10
Konkluzione dhe Rekomandime	7

Përmbledhje ekzekutive.

Plani i Integritetit Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM) është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuara në 2 fusha të përgjegjësisë institucionale të QKMBM. Plani i Integritetit për vitin 2025 është vijim i realizimit të projekteve të planifikuara gjatë vitit 2025 dhe përmban gjithsej 100 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar.


Afati i zbatimit dhe realizimit të këtij Plani të veprimit të Planit të Integritetit ishte 1 janar - 31 dhjetor 2025.

Në përputhje me kreun 1, pika 1.2, të Planit të veprimit të Planit të Integritetit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM), si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për Ministrinë e Mbrojtjes, QKMBM ka hartuar këtë raportin vjetor të monitorimit mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti vjetor jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të QKMBM për vitin 2025 dhe statusin e zbatimit të tyre, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, si dhe përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të QKMBM të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, burimeve njerëzore dhe profesionale, si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

Për vitin 2025, në Planin e Integritetit të QKMBM ishin parashikuar për zbatim 65 aktivitete, në realizim të vizionit dhe objektivave të mësipërme.

Nga monitorimi rezulton se në totalin gjatë vitit 2025 janë realizuar 94 aktivitete në total, përtej parashikimit të bërë.



Qasja vlerësuese.

Raporti i monitorimit vjetor të zbatimit të Planit të Integritetit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM) për vitin 2025, përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit, si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të brendshëm pune dhe të koordinatorit të Integritetit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM). Raporti për vitin 2025, përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti vjetor bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM), në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit të MM mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i strukturës merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të dala në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të Forcave të Armatosura (QKMBM).

Mbledhja e informacionit nga është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secili sektor ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim përgjatë të vitit 2025; akte dhe dokumente të hartuara; rekomandime dhe konkluzione. Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, raporti është miratuar nga drejtori i Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM).


GJETJET E RAPORTIT

Objekti 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike.

Përmes këtij objekti synohet pjesëmarrja në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë të një sërë aktorëve, qofshin institucione shtetërore apo media, grupe interesi dhe shoqëri civile në përgjithësi, duke garantuar që politikat dhe vendimet në lidhje me mbrojtjen të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat strategjike, dhe që problemet të mund të identifikohen që në një fazë të hershme.

Objektivi 1 përmban një numër prej 14 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga QKMBM për vitin 2025, nëpërmjet 65 aktiviteteve kryesore. Gjatë periudhës raportuese një vjetore rezulton se janë realizuar plotësisht masat e parashikuara (produktet), si dhe nga monitorimi përfundimtar rezulton se janë kryer të gjitha aktivitetet, sipas tabelës më poshtë:

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Masa të përealizuara për vitin 2025	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Aktivitete të përealizuara për vitin 2025
Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	Ngritja e komisionve vepruese përgjatë vitit sipas aktiviteteve/misioneve të përcaktuara nga QKMBM-ja , me qëllim realizimin e një procesi transparent dhe demokratik.	14	0	65	0




Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Ky objektivi përmban një numër prej 21 masash specifike dhe 18 aktivitete të planifikuara për t'u zbatuar për vitin 2025 nga njësitë e përfshira. Nga mbledhja e raportimeve nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase rezulton se kjo masë vijon të ngelet e realizuar në masën 90%.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Masa të parealizuara për vitin 2025	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Aktivitete të parealizuara për vitin 2025
Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës e llogaridhënies	Rritja e kapaciteteve të punësimeve procedohet në bazë të kriterëve të publikuara në faqen zyrtare të Web sipas kërkesave për plotësimin e vakancave.	21	0	18	0

Objektivi 2



- Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuar
- Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara
- Masa dhe aktivitete të parealizuara

Aktivitetet e këtij objekti i referohen specifikisht forcimit të kapaciteteve profesionale me organizimin e trajnimeve për politikat e privatësisë, rishikimin e përkrahjeve të punës, duke përfshirë detyrat që burojnë nga ligje të veçanta në to, përfshirjen në trajnime për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe trajnimin e rregullt në lidhje me antikorrupsionin.


Objekti 3: Transparencë pro aktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.

Ky objektiv për vitin 2025 përmban një masë dhe një aktivitet. Në pikën 3.2 parashikohet përfshirja e trajnimeve të auditimit të performancës në planin vjetor të trajnimeve.

Kjo masë është përmbushur 80%.

Objekti 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Masa të përfshirura për vitin 2025	Aktivitetet të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2025	Aktivitetet të përfshirura për vitin 2025
Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik	Ngritja e komisionit të prokurimit publik, të bërë me vlerë të vogël, sipas ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurime publike”. Shmangia e konfliktit të interesit në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik	14	0	8	0

Objekti 3.



Konkluzione dhe Rekomandime:

Ky raport monitorimi për vitin 2025 është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2025, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM), ka vijuar me zbatimin dhe monitorimin e planit të integritetit duke përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë dokument;
- Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM), është e angazhuar dhe ndjek zbatimin e Planit të Integritetit;
- Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes (QKMBM), për publikun e gjerë, nëpërmjet faqes së internetit.